

ERIOLA AGALLIU

**FIGURA E FEMRËS NË PËRFYTYRIMIN POETIK  
TË VEDAT KOKONËS**

*“E kërkuj vehten t’ime jashtë meje dhe e gjej tek ty.  
Të kërkuj ty jashtë meje dhe të gjej në vehten t’ime.”<sup>1</sup>*

(Maurice Maeterlinck)

Këto vargje të Maeterlinck hapin vëllimin poetik me titull “Dritë dhe hije” të Vedat Kokonës. Që në leximin e parë, të këtij dedikimi, kuptojmë edhe qëllimin ose tharmin krijues të poetit të ri të viteve ’30. Shqetësimi i tij (nëse mund ta quajmë kështu) shfaqet në kërkimin apo njohjen, e Vetes dhe të Tjetrit. Në këtë rast, Tjetri është dashuria, qenia femërore me të cilën identifikohet ajo. Si një libër i frymëzimit spontan, poezitë shfaqin rrugëtimin e saponisur të një djaloshi në shtigjet e poezisë. “*Me këtë kanisk isha nisur në dasmën e letërsisë*”<sup>2</sup> - pohon vetë krijuesi në librin e tij me kujtime “*Endur me tisin e kohës*”. Me një parathënie korrekte (edhe pse e nisur në rrethana njohjesh familjare) nga Lumo Skëndo vëllimi prej 19 poezish del në shtyp në vitin 1939. “*Kritika dhe studimi i vjershavet nga pikëpamja e estetikës s’është vetëm një gëzim ose një zbavitje spirituale për atë që e bën. Është edhe një ndihmë për zgjanimin e kuptimit tënë, çelje e dritarevet që na rrinin mbyllur*”<sup>3</sup>, - shkruan në këtë parathënie njohësi i shkëlqyer i letërsisë dhe publicisti i njohur, për të cilin vetë Kokona flet me admirim në librin e kujtimeve.

Të botoje një vëllim poetik, në fund-vitet ’30 të shekullit të kaluar, nuk duhet të ketë qenë fort e lehtë përballë emrave të shumënjohur të Asdrenit, Fishtës, Koliqit, Poradecit, Nolit e Migjenit. Konkurrenca duhet të ketë qenë e fortë sidomos për një krijues të ri, i cili kishte njohje shumë të mira të letërsisë franceze por, mbi të gjitha, kishte pasionin e madh për poezinë.

Në këtë analizë ne do të përpiqemi të konfigurujmë imazhin femëror në përfytyrimin poetik të Vedat Kokonës, si një ndër poetët më të rinj të atyre viteve.

Në lidhje me figurën femërore në letërsinë shqipe e shohim me vend të përmendim këtu një citim nga Resmije Kryeziu, e cila në librin studimor të saj

<sup>1</sup> V. Kokona, *Dritë dhe hije*, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939.

<sup>2</sup> V. Kokona, *Endur me tisin e kohës*, Botimet Kokona, Tiranë, 2005, f. 74.

<sup>3</sup> V. Kokona, *Dritë dhe hije* (parathënia nga Lumo Skëndo), SHB “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939.

“Femina Litterarum: romantizmi, sentimentalizmi, simbolizmi, realizmi, ekspresionizmi” pohon:

“...Linja që ndjek letërsia jonë në trajtimin artistik të personazhit të gruas ecën prej glorifikimit të shëmbëlltyrës, pamjes, bukurisë, virtyteve të saj, shquarjes së rolit në historinë e shkuar nacionale e deri te theksimi i drejtpërdrejtë apo indirekt i pozitës së saj të nënshtruar”<sup>4</sup>.

Kështu nga Serafina e De Radës, te imazhi platonik i Naimit, te Marigoja e Çajupit e deri te Tringa luftëtare e Fishtës përvijohen në letërsinë shqipe disa portrete femërore të cilat i lidh bukuria fizike dhe shpirtërore. Një imazh ky, i ngjashëm deri diku me zanat e folklorit dhe me muzat e mitologjisë greke. Vite më vonë, poezia shqipe, mes dy luftërave botërore, sjell, për herë të parë në vargje, modele femërore të ndryshme nga njëra-tjetra. Ndërthurur në këtë mënyrë, para nesh shfaqet portreti i idealizuar i Poradecit, portreti tragjik i Migjenit apo imazhet e ngritura mbi modele popullore, të femrës, në poezinë e Ali Asllanit. Në vijim të kësaj ideje mund të pohojmë:

“... mund të thuhet se ideali estetik i Ali Asllanit afrohet më shumë me atë të poetit anonim popullor. E dashura e tij është trëndafil i mbirë me hënë, zogëzë, pëllumbeshë, dallëndyshe, guguftu, pjeshkëzë etj.”<sup>5</sup>

“Lasgushi, duke e ndërtuar botën në të cilën në çdo hap mbretëron dashuria, krijon figurën e gruas, që e paraqet nëpër një sërë poezish, ndër të cilat vetëm i pasuron tiparet e saj të idealizuara”<sup>6</sup>. [...] “S’ka dyshim se idealizimi i gruas në stilin naimian është vazhdim i ndjeshmërisë romantike edhe në poezinë e Lasgushit”<sup>7</sup>.

“Gruaja në poezinë e tij (kupto: Migjenit - E.A) sado që nuk është subjekt kryesor, gjithsesi është bartëse e dhembjes së madhe nga e cila lëngonte i tërë populli. Të gjitha poezitë, ku gruaja është e pranishme, pothuajse u ngjajnë strofave të një poeme të gjatë të mjerimit të përgjithshëm.”<sup>8</sup>

Në raport me të gjithë poetët e sipërpërmendur modeli femëror që na ofron Kokona në vargje shfaqet i ndryshëm. Një model tokësor e real, do të thoshim, por i huaj në qasjen e tij kundrejt shoqërisë shqiptare të kohës. Po përse zgjodhëm V. Kokonën me vëllimin e tij poetik “Dritë dhe hije”? Së pari, sepse ky punim është pjesë e një studimi më të gjerë për autorin dhe kontributin e tij në letërsinë shqipe mes dy luftërave botërore. Së dyti, sepse besojmë se vëllimi poetik, i paraqitur këtu, ka nevojë ende për një analizë të mirëfilltë shkencore, me qëllim përcaktimin e vlerave të poetit në fjalë.

<sup>4</sup> R. Kryeziu, *Femina litterarum*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2008, f. 24.

<sup>5</sup> B. Gaçe, *Ali Asllani në kujtimet dhe studimet letrare*, Toena, Tiranë, 2006, f. 306.

<sup>6</sup> R. Kryeziu, *Femina litterarum*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2008, f. 287.

<sup>7</sup> Po aty, f. 294.

<sup>8</sup> Po aty, f. 405.

Vedat Kokona vjen në poezinë shqipe me një tufë lirikash intime - meditative që shfaqin, më së miri, drithërimat e një shpirti rinor, të sapoardhur nga Franca.... Dritë dhe hije si kontrast nuk është gjë tjetër veçse një model romantik i poetëve francezë që kishin frymëzuar djaloshin e ri. Ky titull vazhdon radhën e gjatë të modeleve të botuara atëkohë “Mall e brengë”, “Hi e shpuzë”, “Sulm e lotë”, “Gjeth’ e lule”.... Kokona ndjek modelin tradicional të poezisë shqipe, në këto vite.

Titujt e poezive në këtë vëllim janë: “Prall’ e vjetër”, “Dram’i ynë”, “Interval”, “Përjetësi”, “Mbrëmje gushti”, “Harmoni”, “Ti, unë dhe shiu”, “Albumi”, “Ligjërime”, “Një provë”, “Fjalë”, “Kontrastë”, “Këngë”, “Kandili”, “Dëshirë”, “Enigmë”, “Premtime”, “Pritje”, “Lamtumirë”.

Nëse do t’i referoheshim kohës kur duhet të jenë krijuar këto poezi, nisur nga faktet biografike të vetë autorit, mund të pohojmë se ato i përkasin periudhës adoleshente të kaluar në Korçë, viteve studenteske në Paris dhe kthimit si i diplomuar në Tiranë.

Tema intime që mbizotëron, e cila mbart në vetvete edhe elemente erotike, i përshtatet më së miri ndjesive personale të djaloshit të ri.

Poezia vjen para nesh në formën e një dialogu të sinqertë e plot ngjyra ku spikat vargu në monokolonë, pa një rimë klasike dhe ku muzikaliteti e ritmi nuk mungojnë. Figura femërore shfaqet boheme dhe e largët, në raport me gjithë atë mendësi anadollake e patriarkale që mbizotëron në vend. Ajo rend të takohet, rri në shoqërinë e heroit lirik mbrëmjeve të gushtit, largohet kur ndihet e lodhur prej tij, apo e zhgënjyer prej ndjenjës. Të gjitha këto janë të pranishme në vargjet e Kokonës larg çdo skeme realiste të familjes apo shoqërisë shqiptare. Vajza shfaqet në këto vargje si femër qytetare, me një botë të pasur shpirtërore dhe që shijon në çdo çast dashurinë. Kështu, portreti i saj realizohet në vargje me penelata të ravijëzuara lehtë, që na kujtojnë deri diku Epokën e Bukur të fundshekullit XIX. Nuk mungojnë në poezi plazhet, fotografitë, albumet, takimet e ngrohta në muzg; imazhe këto të jo fort të pranishme dhe, ca më pak, të pranueshme në shoqërinë shqiptare të asaj periudhe. E duket se, në këtë pikë Vedat Kokona nuk ngjan me asnjë nga poetët bashkëkohës me të. Modeli liriko-heroik i Fishtës në portretin femëror, modeli lirik adhures gjer në përjetësi i Lasgushit dhe modeli skandaloz ironizues i Migjenit qëndrojnë larg kësaj “poezie salloni” sikurse u quajt krijimtaria në vargje, e atyre viteve e poetit. Parë në këtë këndvështrim, në vargje vihet re një frymë perëndimore në kuptimin më të parë dhe më të plotë të kësaj fjale. Në një nga poezitë në hyrje të vëllimit, Vedat Kokona shkruan:

*“Të pashë parmbremë. Dikush të shoqëronte.*

*Dikush - një tjetër - me ty po shëtiste.*

*Ish ora kur me hije natyrën e mbulonte*

*nata dhe prapa malit hëna kur shëndriste.*

*Të pashë. U - drodha. Diçka zëmrën m'a ndrydhi;.....*<sup>9</sup>

Sikurse shihet, në vargjet e mësipërme, figura femërore shfaqet e lirë të jetojë dhe të shijojë ndjenjat e saj. Përballë këtij fakti poeti vuan dhe... hesht. Ky reagim tregon se nuk kemi modelin e mashkullit shqiptar, të revoltuar dhe të gjithëpushtetshëm në raport me femrën, por një hero lirik të dashuruar, sipas modelit të poezive romantike evropiane. Shohim në vargje, se është djaloshi i dashuruar ai që tronditet. Drama është e pakthyeshme dhe gjendja emocionale tendoset vetëm brenda një vargu: *“Të pashë. U - drodha. Diçka zëmrën m'a ndrydhi;...”*

Në poezinë “Interval” lexojmë:

*“Do të shkoj - më the - sonte s'më ke pranë  
si mbrëmë. Do t'ikij dhe ike e më le vetëm;  
vetëm me hijen t'ime këtu më nj'anë  
të dhomës s'onë....”*<sup>10</sup>

Në vargje shohim një ndarje të përkohshme, me qëllim që e nesërmja të ringjallë edhe njëherë ndjenjën e dashurisë. Përshkrimi të ndjenjave këtu i shtohet edhe dialogu. Një poezi intime, me elemente rrëfimtare, që, në rrafshin gjuhësor, shfrytëzon teknikën e përbaljes mes dy zërave në poezi. Nëse do t'i referoheshim këtu titullit të vëllimit “Dritë dhe hije”, ne e kuptojmë që bëhet fjalë për një dashuri apo ndjenjë të fortë, e cila me praninë dhe mungesën e saj e trondit shpirtin e poetit. Në intervalin e ikjes, humbjes së dashurisë ai mbetet një hije e vetmuar, e errët, e padukshme brenda territorit të natës.

Simbolika e dritës dhe hijes shfaqet pareshtur në poezi të ndryshme. Sikurse vihet re, në poezinë me titull “Përjetësi” shpirti i poetit ka dyshime të shprehura në trajtën:

*“Më duket nganjëherë sikur të kam harruar, -  
sikur ti je një hije në hije të zëmrës s'ime;  
një frym' e lehtë e lehtë që shkel mbi kraharuar,  
një flak' e zbetë e zbetë që rron në drithërime.*

*Por ja ashtu ngadale ndajnata sa afrohet  
dhe hëna mbush me dritë gjith kupën qiellore,  
një fllad më shkon kulluar në shpirtin që trazohet;  
ti lind në zëmrën t'ime e ëmbël, madhështore.”*<sup>11</sup>

<sup>9</sup> V. Kokona, *Dram' i ynë, Dritë dhe hije*, SHB “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939, f. 13.

<sup>10</sup> V. Kokona, *Interval*, po aty, f. 15.

<sup>11</sup> V. Kokona, *Përjetësi, Dritë dhe hije*, SHB “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939, f. 17.

Në të dyja strofat shohim se metaforat e përshkallëzuara “një hije, një frym’, një flak’...” shndërrohen në “një flad më shkon kulluar në shpirtin që trazohet”.

Kështu, duke qenë poezi të frymëzimit spontan, vihet re ekzistenca e gjithëkohshme e dashurisë si një bashkëshoqëruese e heshtur e heroit lirik. Vargu i cituar më lart mbart njëherësh lumturinë e zemrës dhe një realitet të prekshëm (të cilin poeti e konsideron një përjetësi), pavarësisht se flet për hijet. Përmes kontrasteve të fuqishme poeti rreket të sendërtojë ndjesitë, edhe pse ato mbeten eterike, të padukshme dhe misterioze si vetë shpirti njerëzor.

Megjithëse në thelb krijimet e Kokonës shfaqen si krijime intime, të cilat konfigurojnë disa elemente meditative, duket se poeti nuk shkëputet dot nga fluturimet rinore të moshës. Vargu i lirë, e në pjesën më të madhe monokolonë, ritmi dhe muzikaliteti, mbizotëruen në raport me rimat e standardizuara, si tregues të modernizmit, nuk ia zbehin kësaj poezie nuancat romantike. Nuanca të cilat burojnë nga mosha dhe përshtypjet rinore të vetë poetit.

Duke cituar Zejnullah Rrahmanin mund të pohojmë se: “Arti romantik, sipas Shlegelit, shpreh të paplotën (ose jouniken), subjektivitetin, disharmoninë e brendshme, të paqartën, të papërsosurën dhe dëshirën. Cilësi të romantikës shfaqen edhe melankolia dhe idealizmi, që tash janë karakteristikat kryesore të artit romantik”<sup>12</sup>.

Përse po e citojmë Shlegelin kur dihet tashmë, botërisht, tharmi krijues romantik, në letërsi?!

Për të saktësuar më së miri se, kur flasim për një frymë romantike në vargjet e Kokonës, ajo qëndron larg skemave tradicionale të Rilindjes sonë Kombëtare. Fryma atdhetare, karakteri luftarak i kësaj të fundit, idealizimi i natyrës dhe virtyteve të shqiptarëve, duhet t’i jenë dukur, në mos të kënduara më parë, të paktën të largëta në kohë një djaloshi 25 - vjeçar (Theksojmë se po flasim vetëm për poezinë pasi dihet se, në shtypin e kohës, Vedat Kokona shfaqet i angazhuar në çështjet shoqërore me kritikën dhe prozën e tij.). I ndikuar nga romantikët e simbolistët francezë në përgjithësi, ky poet i ri sjell në vargje botën e tij të trazuar shpirtërore, një “*beau esprit*” sikurse do ta quante vite më vonë Aurel Plasari në parathënien me titull “Vedat Kokona ende për t’u rizbuluar”, botuar në hyrje të vëllimit “Quo vadis letërsi shqipe dhe shkrime të tjera kritike”.

Në vargjet e mëposhtme lexojmë:

“... Sonte një poezi  
e pa - kufishme vlon në shpirtin t’im q’ëndëron  
një kthjelltësi qiellore edhe dy yj.

<sup>12</sup> Z. Rrahmani, *Teoria e letërsisë*, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008, f. 51.

*Sonte nuk dij sepse mëndja më shkon  
tek jeta e pambaruar dhe tek ty.*<sup>13</sup>

Sikurse shihet, përtej ndjenjës intime kemi heroin lirik që mediton. Përballë natës dhe heshtjes qiellore vjen frymëzimi, poezia e pashkruar (“*këngët e pakëndueme*” do të thoshte Migjeni dhe Lasgushi do të shtonte “*o gjuh’ e zemrës sime, o mos e kuvenduar*”) që përmbledh ndjesitë e një shpirti djaloshtar. Po përse mendja shkon tek “*jeta e pambaruar*”?! Sepse është shqetësimi i një shpirti të trazuar që rreket të gjejë kuptimin e ekzistencës. Sapo ka hyrë në udhën e jetës dhe në planin “filozofik” gjykon se gjithçka po ikën shpejt (A nuk është e vërtetë se kur jemi 20-vjeçarë na duket se jeta na shkoi pa e kuptuar?!). Ne shohim prapa kthjelltësisë qiellore dhe dy yjve, vizionin e një të ardhmeje plot shpresa e ëndrra të realizuara, të dy të dashuruarve.

Jemi në fund të viteve ’30 të shekullit të kaluar. Një epokë ndryshimesh rrënjësore në të gjitha fushat. Edhe pse në një rendje masive drejt qytetërimit modern perëndimor, lidhjet me folklorin janë ende të forta dhe të dukshme në një pjesë të madhe të poetëve shqiptarë. Fryma folklorike duket se motivon në tema, vargëzim, imazhe peizazhi të natyrës shqiptare e sidomos në portretin e idealizuar të vashës shqiptare, ku në mënyrë aq të skalitur spikat bukuria fizike, në harmoni me bukurinë morale të saj. Këtij modeli, të tejkonsumuar, (edhe pse, ndër vite dhe me raste, i suksesshëm) Kokona as nuk tenton t’i afrohet. Nuk e dimë për ç’arsye (përveç faktit biografik: viteve të studimit në Francë dhe moshës së re të poetit) kjo poezi qëndron larg çdo ndikimi nga letërsia e poezia popullore shqiptare. Në vargjet e këtij poeti nuk gjejmë as poezi me vargje 8 - rrokësh, as figurën e vashës dhe trimit, as takimin të kroi apo kisha e fshatit, as imazhet idilike të natyrës shqiptare. Në një poezi lexojmë:

*“Çudite pse nuk flas. Më pyet përse kam heshtur.  
Ke frikë se mos të kam harruar,  
se mos e shpije mëndjen gjetiu. Jo e adhuroar.  
S’mejtoj asgjë, vetëm dëgjoj shiun që pa rreshtur  
bije përjashta ngadalë, ngadalë....”*<sup>14</sup>

Krijimi i një dialogu të ngrohtë gati - gati me tone miqësore, shpreh në të vërtetë përkujdesje, brengë e pasion. Ndjenja që ndërthuren së bashku për të na dhënë një mikrobotë, që në vetvete mbart përsiatjet për botën e madhe. Biseda mes dy të rinjve, dhoma e vogël, shiu që bie nuk janë gjë tjetër veçse tablo ndjenjash të cilat përsëriten pareshtur në faqet e vëllimit poetik. Ky

<sup>13</sup> V. Kokona, *Mbrëmje gushti, Dritë dhe hije*, SHB “Kristo Luarasi”, 1939, f. 18.

<sup>14</sup> V. Kokona, *Ti, unë dhe shiu, Dritë dhe hije*, SHB “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939, f. 20.

dialog i të dashuruarve, vendtakimi i tyre dhe fjalët që pëshpërisin na shtyjnë të besojmë se kemi të bëjmë me dy qenie të pavarura nga pikëpamja mendore (ndoshta edhe intelektuale), të cilat kanë zgjedhur të jenë bashkë. Figura femërore shfaqet në të njëjtin nivel me heroin lirik, e lirë në zgjedhjet dhe dëshirat e saj.

Në një nga poezitë e tij, Kokona vendos dedikimin:

*“Ton Passé! Car tu as un Passé toi aussi!*

*Un grand Passé, plein de bonheurs et plein de peines...”<sup>15</sup> (Paul Géraldy)*

Janë dy vargje të poetit francez Paul Géraldy i cili shquhet për një poezi të thjeshtë, të kuptueshme e të drejtpërdrejtë në kontaktin e saj me lexuesin. Shpesh, vargjet e tij janë quajtur nga kritika si poezi të modës së vjetër, pikërisht për fjalorin disi naiv, që përdorte poeti.

E megjithatë, poshtë këtyre vargjeve Kokona krijon poezinë:

*“Shëko! Shëko! sa bukur ke dalë këtu!  
Sa të kanë hije leshrat q’i ke prerë!  
Më dukesh ndryshe! Vetëm nga syt’ e tu  
të njoh, se ata nuk janë të tjerë....  
Mos e mbyll albumin. Për kokën t’ënde  
që nuk qesh me ty. Mos ji e marrë!*

Flokët e prerë të vajzës, në mos imazhin e një vajze qytetare shqiptare, krijojnë qartazi portretin e çiltër të një dashurie studentore. E gjithë poezia vjen para nesh në formën e një dialogu, ku figura femërore është e pranishme vetëm me buzëqeshjen apo ndrojtjen e saj. Heroi lirik është ai që pyet dhe përgjigjet, duke arritur ta shfaqë këtë tekst (të mundshëm për një tregim) në formën e një poezie intime me varg të lirë.

*Shëko! Shëko! sa të bukur janë këto vënde  
ku në fotografi të kanë marë....  
Më thuaj, a i ke edhe sot ner mënde  
Gjith këto bukurira që ke parë?  
Ku ke dalë? Atje ku kishë shkuar  
me familjen t’ënde vjet një verë  
për të kaluar?<sup>16</sup> [...]*

Në vargje, rrëfëhet gjithë një jetë e kaluar, me çastet që ofron albumi i fotografive. Poezia ka shumë ngjyra, dritë, tinguj të gëzuar, të cilët na shfaqin

<sup>15</sup> *Albumi*, po aty, f. 22.

<sup>16</sup> *Albumi*, po aty, f. 23.

të plotë një jetë të mëparshme, plot hare. Vetë poeti zbulon në mënyrë të sinqertë ngazëllimin e tij përballë këtij fakti. Në mbështetje të kësaj ideje mund të citojmë Alfred Uçin i cili shprehet se, sipas Ogyst Kontit: “*Ndjenja, me gjithë shfaqjet e saj, nuk është gjë tjetër, veçse një aftësi instiktive për të dalluar në çast përsosmërinë*” (*domethënë bukurinë*)...<sup>17</sup>.

Sikurse dallohet qartë, në këtë poezi, heroi lirik i dashuruar shijon dhe shquan në figurën e vajzës bukurinë dhe përsosmërinë e vetë dashurisë. Ky shfletim i albumit të fotografive nuk është gjë tjetër veçse nënteksti metonimik i rrëfimit të së shkuarës. Ato sekrete të së djeshmes që dy të dashuruarit rishtas, do ia pohonin njëri - tjetrit me fjalë, poeti i shpreh nëpërmjet imazheve të ndalura në foto.

E megjithatë, nga fotot ne njohim vetëm portretin femëror, por cili është portreti i vetë heroit lirik? Le t’i referohemi një tregimi me titull “Lush Bardhi” shkruar po në vitin 1939 dhe botuar, së fundmi, në përmbledhjen me tregime “Lutja e fundit” të Vedat Kokonës. (Nga të dhënat biografike dimë se emri i këtij personazhi është përdorur edhe si pseudonim nga Kokona në shkrimet e tij publicistike të kohës.) Në këtë tregim lexojmë për një mësues të ri, Lush Bardhin, i cili pasi përfundon studimet jashtë shtetit kthehet në atdhe:

“Po kthehej një herë e mirë në vendin e tij, ku kishte lindur e ku do të vdiste, në Shqipëri! Jeta që kishte shkuar në atë qytet të huaj, ku mijëra herë me radhë zemra i kishte rrahur në hove dëfrimi të pafrenueshme, ku i dukej se kishte lindur për herë të dytë, nuk ishte në të vërtetë veçse një udhëtim i vogël, një mirazh në shkretëtirën e zemrës. Ishte larg tani Parisi i bukur, Pylli i Bulonjës ku shkonte për të shëtitur të dielave, ose për të vozitur mbi liqenin e vogël me varkë; larg Montmartrë me dëfrimet e ëmbla larg Kartie - Latini i shqetësuar, Luksemburgu i qetë, Fakulteti dhe pranë, hoteli ku kishte banuar. Nxorri portofolin dhe mori andej një tok fotografi që kishte bërë në një jetë të shkurtër studenti. Ishin pothuajse të gjitha fytyra mikeshash që kishte njohur dikur në hijet e kopshteve, në shkëlqimin e veluar të dancingeve, në frontet e amfiteatrit, leshverdha, të zeshkëta, të stolisura, me një buzëqeshje të ëmbël në fytyrë.”<sup>18</sup>.

Mund të pohojmë se portreti i Lush Bardhit i ngjan sa vetë poetit, po aq edhe heroit lirik, i cili shfaqet në vargjet e Vedat Kokonës. Shfaqet portreti i një djaloshi intelektual të dashuruar më fort pas letërsisë, sesa pas drejtësisë për të cilën ishte diplomuar, plot ëndrra e ideale, që ruan thellë në shpirt kujtimet për Francën.

<sup>17</sup> A. Uçi, *Universi estetik – bota moderne*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2007, f. 358.

<sup>18</sup> V. Kokona, *Lutja e fundit*, Botimet Kokona, Tiranë, 2008, “Lush Bardhi”, f. 143.

Në po të njëjtën poezi lexojmë:

*O! po këtu kush ka dalë me ty  
buzës së detit plot me dritë?  
Një shok i vjetër? Ju laheshit të dy  
në këtë det ditë për ditë?  
Vërtet ay të ka shoqëruar  
kur ti ke dalë për të shëtitur  
bregut të detit të qetësuar  
aher ndajnata me të zbritur?  
Të dy, sa herë, i keni thënë  
ju njeri tjetrit me mijëra fjalë...  
edhe një mbrëmë edhe një mbrëmë,  
rrezen e hënës përmbi valë  
e keni parë ashtu kur bije  
gjerdhan i gjatë plot xhevahirë.  
Eja, e dashur, shkojmë në hije,  
se atje në hije ishim më mirë... ”<sup>19</sup>*

A do të guxonim më tepër sesa duhet nëse do të pohonim se, në thelb të gjithë poezive qëndron e njëjta femër?! Nuk mund ta pohojmë me siguri këtë fakt. Aq më tepër që në vetvete kjo e dhënë biografike nuk ndikon në vlerat apo anti - vlerat e vargut. Ajo çka bie në sy, në këtë rast, është portreti femëror modern për kohën (“*me leshrat prerë*” pohon poeti)si dhe me një moskokëçarje sa të dukshme aq edhe joshëse në portret. Prania e Tjetrit, e atij që sheh nga fotoja, dhe që i përket së shkuarës vjen natyrshëm në poezi, larg çdo mllef i a indinjate hakmarrjeje primitive, nga ato që kishim dëgjuar më parë. Madje edhe dy vargjet e fundit mbartin më shumë nota të një ironie të lehtë dashamirëse kundrejt vajzës, kur poeti pohon se do të donte të ishte më mirë në hije për mos t’i shquar disa nga imazhet e së shkuarës. Ai e pranon ekzistencën e tyre, sikurse na tregojnë edhe vargjet nga Paul Geraldly në hyrje të poezisë, edhe pse në thellësi kërkon t’i shmangë këto imazhe. Vargu në monokolonë (sikurse ndodh gjithmonë te Kokona) nuk tregon gjë tjetër veçse dëshirën e heroit lirik për të qenë vetë aktor dhe spektator i dialogut të tij.

Një ndër poezitë më të ndjera të vëllimit është ajo me titull “Këngë”:

*Shkuan të gjitha, por ja, s’ dij pse sonte  
pas kaq kohësh harrëse fillon te  
zëmra ime sërish vargu  
i ëndërrimeve të gjata që dikur bëra.  
Dhe rrij e i kujtoj orë të tëra*

<sup>19</sup> *Albumi*, po aty, f. 23-24.

*ëndërat që vinë që prej së largu...  
Sepse, shumë herë në këtë jetë, diçka,  
diçka, asgjë... një shi që bije,  
fletë qëçelin ca nga ca,  
një dritë kandili ose një hije,  
një natë pa gjumë e plot vegime,  
një fotografi, një letër,  
ngjallin sërish në zëmrën t'ime  
një dashuri të vjetër.*<sup>20</sup>

Poeti mbledh e ruan reliktet e një dashurie. Kujtime që shfaqen me tërë bukurinë dhe mizorinë e tyre e shoqërojnë në heshtje. Edhe pas ndarjes, zemra përsërit ëndrrat e shkuara, imazhet e mbetura në fotografi apo në pusulla letre. Poeti përjeton të njëjtat ëndrra që ringjallen sërish. Është dhimbja e një shpirti rinor, i cili, në pamundësi për të harruar, lexon në objektet dhe sendet përreth pikëllimin e tij. Nëse do t'i referoheshim përsëri Alfred Uçit, ai citon *Shatobrianin* (një ndër poetët e preferuar të Vedat Kokonës) i cili thotë se:

*"Bukuria ideale e artit qëndron në aftësinë për të zgjedhur dhe për të paraqitur. E vërteta dhe ideali, janë dy burimet e interesimit poetik: e mallëngjyeshmja dhe e mrekullishmja"*<sup>21</sup>.

Poezia me titull "Këngë" përpiqet të rrokë pikërisht këtë përmasë, ku e vërteta dhe ideali, të ndërthurura së bashku shndërrohen nga një dhimbje personale në një nivel estetik që shfaq idenë e së mrekullueshmes.

Në poezinë me titull "Kandili" lexojmë:

*"E shëkon nër këmbët t'ona se si po luhet  
vallja e hijeve që na shoqërojnë sonte?  
I shoh që po lëvizin pranë nesh, me ngadalë.  
E shoh vallen e tyre që vjen pors një valë  
e lehtë. Vallë ku do të shtrihet? Ç'kërkon te  
syr' i yt i fjetur? Mos do të thotë një fjalë?  
Me hijet rrotull nesh nër ëndra kredhur mirë,  
të valles s'amëshuar të humbur në nj'anije,  
né ecim krahu për krahu atje në shkretëtirë  
të jetës së pa - njohur. Dy drita dhe dy hije."*<sup>22</sup>

Poeti ravijëzon imazhet nën dritën e një kandili. Loja me dritën dhe hijet, e cila ka qenë e pranishme në sfond të thuajse çdo poezie, tani

<sup>20</sup> *Këngë*, po aty, f. 31-32.

<sup>21</sup> A. Uçi, *Universi estetik – bota moderne*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2007, f. 158.

<sup>22</sup> *Kandili*, po aty, f. 34-35.

qendërzohet në formën e një valleje simbolike që mbështjell dy të dashuruarit. Përsëri kemi një dialog të munguar në formën e pyetjeve retorike, të cilat e ndihmojnë poetin të shfaqë dilemat dhe hamendjet e tij. Ky sfond simbolist i poezisë krijon kontrastin e plotë mes dy të dashuruarve (drita dhe ëndrra) dhe realitetit të ashpër (hija dhe jeta). Tonet melankolike të pranishme në poezi nuk shpien deri në fatalitet. Përtej vështirësive, tallazeve, territ të jetës poeti pohon se *“ecim krah për krah”* duke i mëshuar idesë se ekzistenca edhe e dritës edhe e hijes janë të pranishme në botën njerëzore. Imazhet simboliste të kësaj poezie na futin në një atmosferë bodleriane edhe pse në vargjet e Kokonës bëhet fjalë për një gjendje kalimtare, që nuk ka të bëjë me atë mërzi e brengë të kudondodhur që e gjejmë te poeti francez.

Në poezinë *“Pritje”* koha ka ndalur dhe poeti shprehet:

*“Ti do të vish. Unë i gëzuar  
hapat e vogla do t’i dëgjoj  
t’afrohen në derën t’ime. Do të ngrihem  
Dhe me të shpejtë, pa zhurmë, do të nxitoj  
tek dera. Ti do të hysh. Do të të shëkoj:  
e ëmbël, e bukur, e adhuruar  
sërish do të më dukesh, “Jam e lodhur -  
do të më thuash - dua të shtrihem  
pak mbi kanape: shkallët s’kanë të sosur!  
Ç’ke bërë?” - dhe kur të jesh dyke folur  
kështu, me ngadalë unë leshrat e tua  
do të t’i puth pa rreshtur, do të të rrëfej  
ç’kam bërë gjith ditën, kohën si e kam kaluar.”<sup>23</sup>*

Poezia shfaq e gjitha një të ardhme të afërt: kur ti të vish. Kështu e rrëfyer në një kushtore të mundshme, poeti shfaq padurimin dhe mallin e tij. Nuk e dimë sesa zgjat ky çast i pritjes por i tronditur nga dyshimet dhe pasioni poeti pohon: *“...Do të gënjesh kur të thuash: të dua?/ Më thuaj ç’ka të duash por vetëm eja!”*.

Poezia e fundit e cila mbyll vëllimin poetik titullohet *“Lamtumirë”*. Nga pikëpamja kuptimore ky cikël hapet me titullin *“Prall’ e vjetër”* si për të na kujtuar se, në të vërtetë çdo histori njerëzore e dashurisë, në vetvete nuk është veçse një përrallë e përsëritur ndër breza.

Vargjet që e hapin këtë libër janë:

*“Kur për të mijtën herë të përsëris se të dua,  
se t’adhuroj cdo ditë edhe më tepër,  
kur me këto fjalë mund të bënja një vepër,*

<sup>23</sup> *Pritje*, po aty, f. 40-41.

*ti rri e qetë dhe më shëkon mua.*”<sup>24</sup>

Janë fjalët e sinqerta që burojnë nga shpirti i heroit lirik. Në përpjekje për të shpallur dashurinë e tij, ai është i gatshëm të krijojë imazhe e metafora pafund. Imazhe të cilat ofrojnë gjithë ato çfarë kemi thënë më lart në lidhje me poezinë lirike të Vedat Kokonës.

Poezia e fundit “Lamtumirë” mbyllet me vargjet:

*“Thuaj! Do m’kujtosh? Thuaj! do të m’i shkruash?  
Vërtet kurrë s’do t’a lësh zëmrën t’ime të ngrirë?  
Vërtet si dje dhe sot dhe nesër do të më duash?  
Puth - më edhe një herë, e dashur. Lamtumirë.*”<sup>25</sup>

Ka kaluar koha, është nata para ndarjes. Poeti ka arritur në stacionin e fundit. Tani nuk i mbetet veçse të ripërtypë kujtimet e së shkuarës dhe të shohë drejt të nesërmes. Gjithçka që mbetet është vetëm dhimbje. Por është një dhimbje nga ajo që të rrit, që të bën më të fortë, që të bën ta shndërrosh gjithë atë ngërç të brendshëm, në vargje zemre. Ajo që nuk na vret, na bën më të fortë, ka thënë dikush.

Djaloshi i ri Vedat Kokona duket se ka gjetur sesi ta realizojë këtë. Pas një çmimi të parë, marrë me tregimin “Lutja e fundit” dhe pas një libri me shënime udhëtimi me titull “Nga Tirana në Stokholm”, pena e mprehtë e Kokonës kishte spikatur në shtypin shqiptar si publicist e kritik letrar.

Këtë radhë kishte tentuar diçka ndryshe. Ndjenja për të bukurën, pasioni për poezinë dhe sidomos kultura e fituar edhe pse me pak përvojë jete, nxorën në dritë këtë vëllim poetik të thjeshtë e, njëkohësisht të sinqertë, në mënyrën sesi komunikon me lexuesin e viteve 1930 dhe viteve 2000.

Sipas Aurel Plasarit, cituar në hyrje të përmbledhjes me shkrime kritike të Kokonës, vetë poetit i pëlqente të përsëriste një thënie të Mopasanit:

*“Prendvera shkund gjithë natyrën e pemëvet të mia dhe më shtyn të prodhoj këto fryte letrare që as vetë s’e di si më dalin...”*<sup>26</sup>

Pranvera e tij e moshës, i realizoi frytet e saj, me vëllimin poetik “Dritë dhe hije”.

## **BIBLIOGRAFI**

A. Uçi, *Universi estetik - bota moderne*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2007.

<sup>24</sup> Prall’ e vjetër, po aty, f. 11.

<sup>25</sup> Lamtumirë, po aty, f. 44.

<sup>26</sup> V. Kokona, *Quo vadis letërsi shqipe dhe shkrime të tjera kritike*, Botimet Kokona, Tiranë, 2006, f. 9.

- B. Gaçe, *Ali Asllani në kujtimet dhe studimet letrare*, Toena, Tiranë, 2006.
- L. Smaqi, *Itinerare që ndërthuren*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2012.
- R. Kryeziu, *Femina litterarum: romantizmi, sentimentalizmi, simbolizmi, realizmi, ekspresionizmi*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.
- S. Hamiti, *Vepra letrare*, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2002.
- V. Kokona, *Dritë dhe hije*, SHB “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939.
- V. Kokona, *Endur me tisin e kohës*, Botimet Kokona, Tiranë, 2005.
- V. Kokona, *Lutja e fundit*, Botimet Kokona, Tiranë, 2008.
- V. Kokona, *Quo vadis letërsi shqipe dhe shkrime të tjera kritike*, Botimet Kokona, Tiranë, 2006.
- Z. Rrahmani, *Teoria e letërsisë*, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2008.

## SUMMARY

### THE FEMALE FIGURE IN VEDAT KOKONA’S POETIC IMAGE

Vedat Kokona is one of the youngest poets of the 1930s of the 20<sup>th</sup> century, in Albania. In this study, we analyze the feminine figure in the lyric verses of this poet in relation to other poets such as Ali Asllani, Poradeci and Migjeni. Our analysis will focus on the poetic volume published in 1939, entitled “Light and Shadow” (“Dritë dhe hije”).

We will try, through text analysis, to shed light on the way it is artistically created, the feminine image, with its entire substratum. In its intimate and meditative form of lyrics, the poet brings in the Albanian literature, the free verse in a mono-column, but with a remarkable rhythm and musicality. As instant poetry, these creations bring detachment from the Albanian folklore in the free verse that they are expressed and in the motives that they treat. In addition, the feminine portrait appears in its human and tangible form, like a real being that knows how to give love and pain, knows how to shine light but also dissolve like a shadow, in the dark of the night. Away from traditional models of time, these poems perfectly outline the spring of Vedat Kokona’s age, which remained eternally 25 years old in poetry...

